



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA ADMINISTRATA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEQA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>2992</u>	Nr. i faqf Br. str / No. pg <u>4</u>	
Data / Datum / Date: <u>09.11.2018</u> Pejë / Peë		

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEQA"**

Adresa; Rruga e UÇK-së, 30000 Pejë, Republika e Kosovës, Nr. tel + 381 039 432 270, info@unhz.eu

**RREGULLORE  
PËR NDARJEN E BURSIVE NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEQA" NË PEJË**

**Pejë, Tetor 2018**



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Në bazë të nenit 17, par.3. dhe 23 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 31.10. 2018 miratoi:

**RREGULLORE  
PËR NDARJËN E BURSIVE TË UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA"-PEJË**

**Neni 1**

**Dispozitat e Përgjithshme**

Më këtë rregullore përcaktohen kriteret, kushtet dhe procedurat e ndarjes së bursave universitare për studentet e studimeve themelore (Bachelor) dhe atyre pasdiplomike (Master) të Universitetit Publik "Haxhi Zeka" në Pejë.

**Neni 2**

**Burimet Financiare**

1. Mjetet për ndarjen e bursave universitare sigurohen nga:

- 1.1. Participimi për studime (tarifat e studimit dhe pagesat tjera administrative), në bashkëpunim më MASHT dhe Ministrinë e Financave;
- 1.2. Pagesat për shërbime komerciale dhe shërbime tjera që bën Universiteti;
- 1.3. Donacionet, dhuratat dhe ndihmat;
- 1.4. Kontratat më organet vendore, ndërkombëtare, publike dhe private për mësimdhënie, kërkimet shkencore, punë artistike dhe konsultimet;
- 1.5. Të hyra tjera në përputhje më ligjin në fuqi.

**Neni 3**

**Kriteret për Ndarjen e Bursave**

1. Për fitimin e bursës universitare studentët e studimeve bachelor dhe master duhet t'i plotësojnë këto kushte:
  - 1.1. Të janë student të rregullt të Universitetit "Haxhi Zeka";
  - 1.2. Ti kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit;
  - 1.3. Të kanë notën mesatare në nivelin Bachelor së paku 9.00 (nëntë) dhe në nivelin Master 9.50 (nëntë pike pesëdhjetë).

- 1.4. Përgjithësisht nga nen-paragrafi 3 i këtij neni, studentët e Fakultetit të Arteve të mos kenë notë mesatare më pak se 9.50 (nëntë pikë pesëdhjetë) në nivelin Bachelor;
  - 1.5. Të mos kenë vit të përsëritur studimi.
2. Për studentët e huaj që nuk janë student të rregullt sipas nen-paragrafit 1.1. të këtij neni, Këshilli Drejtues mund të vendos me vendim të veçantë për bursa të caktuara, pas përfundimit të procedurave të mobilitetit të studentëve.

#### **Neni 4 Lartësia së Bursës**

Lartësia e bursës universitare do të përcaktohet nga Këshilli Drejtues i Universitetit për çdo vit akademik me një vendim të veçantë, varësisht nga buxheti dhe numri i studentëve që i plotësojnë kushtet.

#### **Neni 5 Çmimi "Student i Dalluar"**

1. Universiteti "Haxhi Zeka" ndan çmimin "Student i Dalluar", ky çmim u takon studentëve të vitit të fundit të studimeve (bachelor dhe master) me notë mesatare 10.00 (dhjetë pikë zero).
2. Në mungesë të tyre çmimi "Student i dalluar", mund tu ndahet edhe studentëve të vitit të fundit të studimeve me notë mesatare jo më pak se 9.5 (nëntë pikë pesë) me së shumti 3 studentëve për çdo Fakultet (njësi akademike).
3. Për këtë çmim mund të konkurrojnë studentet me propozim të Fakulteteve përkatëse në konsultim me Rektorin.
4. Lartësinë e çmimit "Student i dalluar", e përcakton Këshilli Drejtues me vendim të veçantë.
5. Dëshmia për "Studentin e dalluar" dorëzohet pas përfundimit të afatit të shtatorit të vitit pasues.

#### **Neni 6 Komisioni për Ndarjen e Bursave**

Shqyrtimin e aplikimeve të studenteve kandidate për të fituar bursën universitare e bën Komisioni përgjegjës i caktuar nga Menaxhmenti i Universitetit, i cili përbëhet prej 5 anëtarëve prej të cilëve tre (3) janë anëtar nga Rektorati dhe dy (2) anëtar nga Këshilli Drejtues.

#### **Neni 7 Njoftimi për Rezultatit**

1. Komisioni për ndarjen e bursave pas shqyrtimit të aplikacioneve të kandidateve, merr vendimin për kandidatet që janë përfitues të bursës dhe të atyre që ju refuzohet kjo e drejte.
2. Vendimi me rezultatet, publikohet në faqen zyrtare të Universitetit.

3. Studentet, përfitues të bursës njoftohen më shkrim për të lartësinë e shumës e bursës dhe informata të tjera të nevojshme.

**Neni 8  
E Drejta e Ankesës**

Kandidatët e pakënaqur më vendimin e shpallur pas publikimit të rezultateve kanë të drejtë ti paraqesin ankesë Këshillit Drejtues në afat prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

**Neni 9  
Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" më 31.10.2018.

**KRYESUESI I KËSHILLIT DREJTUES**

Nur Çeku

